

# ARSIMIMI NË GJUHËN SERBE NË KOSOVË



Nëntor, 2018



 European  
Union  
Kosovo



NORWEGIAN EMBASSY

Co-financed by the  
Royal Norwegian Embassy in Pristina

## Falënderim

“Arsimimi në gjuhën serbe në Kosovë” është hulumtim i Qendrës Evropiane për Çështje të Minoriteteve në Kosovë (ECMI Kosovës), në kuadër të projektit “Mbështetje për arsimimin në gjuhën serbe në Kosovë: procesi i verifikimit të diplomave të UMV-së, hulumtim mbi gjendjen aktuale, zhvillimi i një udhërrëfyese të MASHT-it dhe përkrahja e drejtpërdrejtë për UMV dhe stafin e tij mësimdhënës”, i cili financohet nga Bashkimi Evropian dhe menaxhohet nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë, me bashkë-financim nga Ambasada e Mbretërisë së Norvegjisë në Kosovë. Me këtë rast falënderojmë Zyrën për Çështje të Komuniteteve në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, si dhe administratën e shkollave përgjegjëse për arsimim në gjuhën serbe në Kosovë, pa përkrahjen e të cilave ky hulumtim nuk do të ishte i mundur.

## ECMI Kosovo [www.ecmikosovo.org](http://www.ecmikosovo.org)

ECMI Kosova është organizata kryesore joqeveritare që merret me çështjet e minoriteteve në Kosovë, me qëllimin e përgjithshëm për të zhvilluar institucione përfaqësuese, përfshirëse dhe të ndjeshme ndaj komuniteteve, dhe që mbështetin një Kosovë të qëndrueshme shumë-etnike. ECMI Kosova kontribuon në zhvillimin, forcimin dhe zbatimin e legjislacionit përkatës, përkrah institucionalizimin e organeve qeveritare që kanë të bëjnë me komunitetet, dhe ngrit kapacitetet e akterëve të shoqërisë civile dhe të qeverisë për të punuar me njëri-tjetrin në mënyrë konstruktive dhe të qëndrueshme.

Rr. Zahir Pajaziti Nr.20 Apt.5  
10000 Prishtinë/Priština, Kosovo,  
Tel. +381 (0) 38 224 473  
[www.ecmikosovo.org](http://www.ecmikosovo.org)

## Vërejtje

Ky publikim është botuar me asistencë të Bashkimit Evropian dhe Ambasadës së Mbretërisë Norvegjeze në Prishtinë/Priština. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e ECMI Kosovës dhe në asnjë mënyrë nuk mund të paraqes pikëpamjet e Bashkimit Evropian dhe Ambasadës së Mbretërisë Norvegjeze në Prishtinë/Priština.

## Copyright

Të drejtat autoriale © Qendra Evropiane për Çështje të Minoriteteve në Kosovë (ECMI Kosova). Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ose të futet në ndonjë sistem të ruajtjes, ose të transmetohet në çfarëdo forme apo me çfarëdo lloj mjeti, elektronik, mekanik, fotokopjues, regjistruar apo tjetër, pa lejen paraprake të ECMI Kosovës.

# ARSIMIMI NË GJUHËN SERBE NË KOSOVË





# PËRMBAJTJA

<b>1. HYRJE</b>	<b>8</b>
<b>2. PROCESI DHE METODOLOGJIA</b>	<b>10</b>
2.1 Intervistat	10
2.2 Zhvillimi i matricave të treguesve bazuar në standardet e BE-së	10
<b>3. TË GJETURAT KRYESORE DHE VLERËSIMI I TREGUESVE</b>	<b>13</b>
a. Vendndodhja dhe lloji	13
b. Informatat statistikore	15
c. Infrastruktura dhe objektet	18
d. Personeli mësimdhënës dhe materialet mësimore	21
e. Arritshmëria dhe normat e braktisjes	23
f. Pjesëmarrja e prindërve dhe puna në komunitet	23
g. Bashkëpunimi dhe shkëmbimet	24
h. Mbështetja e jashtme dhe/ose investimet	24
i. Sfidat	25
<b>4. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME</b>	<b>28</b>
<b>5. REFERENCAT</b>	<b>31</b>

## LISTA E DIAGRAMEVE

- 3.1 Llojet e shkollave
- 3.2 Numri i nxënësve sipas gjinisë
- 3.3 Numri i nxënësve nga komunitetet jo-shumicë
- 3.4 Numri mesatar i nxënësve për mësimdhënës
- 3.6 Proporcioni i objekteve për një shkollë (veriperëndim)
- 3.7 Proporcioni i objekteve për një shkollë (qendër)
- 3.8 Proporcioni i objekteve për një shkollë (juglindje)

## LISTA E TABELAVE

**Table 1.** Shkollat fillore

**Table 2.** Shkollat e mesme

**Table 3.** Paralelet e ndara

## LISTA E SHKURTESAVE

<b>BE</b>	Bashkimi Evropian
<b>KiE</b>	Këshilli i Evropës
<b>MASHT</b>	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
<b>ONM</b>	Organizata Ndërkombëtare për Migrim
<b>UNMIK</b>	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
<b>USAID</b>	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar

## PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

---

Arsimi përbën njëren prej shtyllave themelore të kornizës ligjore të Kosovës për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve, përfshirë të drejtën që t'iu ofrohet arsimim publik në gjuhën e tyre. Aktualisht në Kosovë funksionojnë dy sisteme arsimore paralele. Njëri prej tyre udhëhiqet nga Qeveria e Kosovës, më saktësisht nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MAShT), ku ofrohet arsimim në gjuhën shqipe, turke dhe boshnjake. Tjetri udhëhiqet nga Republika e Serbisë, Ministria e saj e Arsimit, Shkencës dhe e Zhvillimit Teknologjik, dhe ofron arsimim në gjuhën serbe. Këto dy sisteme arsimore në Kosovë nuk e njohin njëri-tjetrin, mes tyre nuk ka kurrfarë pikëprekje në ndonjë nivel, dhe funksionojnë pranë njëri-tjetrit të ndarë që nga viti 1999. Megjithatë, marrë parasysh tërë kompleksitetin e tij, ky studim nuk trajton statusin ligjor të sistemit paralel të arsimit në Kosovë.

Ekziston një mungesë e theksuar e njohurive mbi sistemin arsimor në gjuhën serbe në Kosovë. Deri më tani asnjë studim nuk ka dhënë një pasqyrë të shtrirjes së saktë të shkollave në gjuhën serbe në Kosovë ose të kushteve në të cilat funksionojnë ato. Prandaj, misioni i ECMI Kosovës është që të të përpiqemi të prezantojmë gjendjen faktike mbi kushtet aktuale në të cilat gjendet arsimimi në gjuhën serbe në Kosovë, të japim një pasqyrë, si dhe të vlerësojmë cilësinë, sfidat dhe mangësitë e këtij arsimimi nëpërmjet treguesve të matshëm, të cilët bazohen në standardet e BE-së për arsim. Qëllimi është që të adresohen nevojat përmes politikave të hollësishme për avancimin e arsimit të ofruar në gjuhën serbe në Kosovë.

Të dhënat e mbledhura janë heterogjene dhe zbulojnë shumëllojshmëri të konsiderueshme kur krahasojmë katër komunat në veriun e Kosovës me zonat me shumicë serbe të shpërndara në pjesën tjetër të Kosovës. Mund të vihet re se shkollat në katër komunat veriore kanë kushte më të mira pune dhe pajisje më të mira sesa shkollat në pjesën tjetër të Kosovës. Në këtë vlerësim theksohen shqetësimet serioze në lidhje me mangësitë infrastrukturore dhe mungesën e hapësirës. Në pjesën jugore të vendit shkollat janë të vendosura në ndërtesa që nuk janë të destinuara për këtë qëllim. Shqetësimet më të mëdha janë për kushtet higjienike dhe mungesën e tualeteve brenda objekteve, sidomos në shkollat që ndodhen në rajonin e Gorës.

Iniciativat për të ndihmuar shkollat në gjuhën serbe në Kosovë deri më tani kanë qenë të fragmentuara dhe pa objektiva të qarta. Komunat veriore përfitojnë nga afërsia me Serbinë dhe mundësitë e shumta për punëtorë të përbashkëta, seminare dhe iniciativa të tjera. Për këtë arsye, ECMI Kosova avokon për veprime të koordinuara për të përkrahur shkollat në gjuhën serbe. Nëpërmjet koordinimit të duhur financiar ndërmjet autoriteteve kosovare, qeverisë së Serbisë dhe komunitetit ndërkombëtar do të shmangej humbja e energjisë dhe fondeve, por kësaj do duhet t'i paraprinte një marrëveshje politike ndërmjet Beogradit dhe Priştina/Priştinës për këtë temë. Duhet hartuar një plan i përbashkët për përkrahje afatgjatë dhe për të dalë me zgjidhje të qëndrueshme.

## 1. HYRJE

Një nga parimet kryesore të mbrojtjes së të drejtave të minoriteteve është qasja e tyre në arsimim në gjuhën e vet.<sup>1</sup> Kjo konsiderohet masë jetike për mbrojtje kundër asimilimit dhe vlerësohet si thelbësore për zhvillimin e identitetit të një minoriteti dhe për dialog ndërkulturor. Në përputhje me standardet ligjore ndërkombëtare, e drejta kushtetuese e Kosovës u garanton komuniteteve të drejtën për të shprehur, ruajtur dhe zhvilluar kulturën e tyre dhe për të ruajtur elementet thelbësore të identitetit të tyre<sup>2</sup>, përfshirë gjuhën, si dhe për të përdorur gjuhën e tyre në sferën private dhe atë publike. Arsimi përfaqëson degë themelore në kornizën ligjore të Kosovës për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve, përfshirë të drejtën që shteti t'u ofrojë arsimim në gjuhën e tyre<sup>3</sup>.

Aktualisht në Kosovë funksionojnë dy sisteme arsimore paralele. Njëri udhëhiqet nga Qeveria e Kosovës, më saktësisht Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), dhe ofron arsimim në gjuhën shqipe, turke dhe boshnjake. Tjetri udhëhiqet nga Republika e Serbisë, Ministria e saj e Arsimit, Shkencës dhe Zhvillimit Teknologjik, dhe ofron arsimim në gjuhën serbe. Shkollat që ofrojnë arsimim në gjuhën serbe gjenden në gjashtë rajone të Kosovës: Uroševac/Ferizaj, Gnjilane/Gjilan, Mitrovica/Mitrovicë, Peć/Pejë, Priština/Prishtinë dhe Prizren (pra, në të gjitha rajonet përveç Đakovica/Gjakovës). Vlerësohet se mësimin në shkollat në gjuhën serbe, ku përfshihen 69 shkolla fillore dhe 34 të mesme, e vijojnë rreth 17.456 nxënës<sup>4</sup>.

Praktika e arsimimit paralel në Kosovë daton që nga periudha para konfliktit të vitit 1998-1999. Pas revokimit të autonomisë së Kosovës nga ana e Republikës së Serbisë më 1980-1990, komuniteti shqiptar ishte tërhequr nga rrjeti arsimor formal dhe kishte organizuar sistemin paralel arsimor privat, i cili nuk njihet nga Serbia. Në njëfarë mënyre, këto sisteme arsimore paralele vazhdojnë të funksionojnë deri më sot, edhe pse rolet janë përmbysur. Pas luftës dhe vendosjes së administratës së Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) dhe pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, rrjeti arsimor i shqiptarëve të Kosovës është ndërtuar në një sistem formal të arsimit. Sistemi në gjuhën serbe është reduktuar në statusin e rrjetit paralel, edhe pse – ndryshe nga rrjeti arsimor private i shqiptarëve, i viteve 1990, i cili nuk përkrahej fare nga shteti – ai përkrahet nga shteti i Serbisë.

Që nga përfundimi i luftës e deri më sot sistemet arsimore paralele që funksionojnë nuk e njohin njëri- tjetrin dhe nuk ka bashkëpunim apo dialog mes tyre. Gjithashtu ka dallime të dukshme në mes të dy sistemeve. Për shembull, arsimi fillor në Kosovë fillon në moshën 6-vjeçare, ndërsa në shkollat në gjuhën serbe një vit më vonë. Ka gjithashtu dallime në organizimin e viteve shkollore: 9 vjet arsim fillor plus 3 të mesëm në shkollat shqipe 5 ; 8 plus 4 në ato të minoritetit serb<sup>6</sup>.

<sup>1</sup> Këshilli i Evropës, Konventa Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare (1995), neni 5 dhe 6.

<sup>2</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 59.

<sup>3</sup> Teksti i plotë: [http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2008\\_03-L047\\_al.pdf](http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2008_03-L047_al.pdf)

<sup>4</sup> Institucioni "Millun Jarsiq" në Skënderaj, Shkolla Bujqësore dhe Gjimnazi në Lipjan/Lipjan dhe shkolla fillore "Sveti Sava" në Shushicë dhe Obiliq nuk kanë ofruar informata statistikore.

<sup>5</sup> Ligji për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, neni 9:

<http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Law%20on%20preuniversity%20education.pdf>.

<sup>6</sup> Ligji mbi Bazat e Sistemit të Arsimit dhe Edukimit (ЗАКОНА о основама система образовања и васпитања), 2017. <https://www.pedagog.rs/wp-content/uploads/2017/10/zosov2017.pdf?v=e892e780304d>



Analizimi i shpërndarjes së kompetencave në të dy sistemet tregon se korniza ligjore e Kosovës ia beson menaxhimin e arsimit parauniversitar MASHT-it dhe Komunave 7 . Juridiksioni i Ministrisë përfshin zbatimin e legjislacionit dhe politikave për zhvillimin e cilësisë, akreditimin e kualifikimeve dhe institucioneve, përcaktimin e granteve specifike për arsim nga Komisioni i Granteve, kohëzgjatjen dhe kornizën kohore të vitit shkollor, madhësinë maksimale të klasave dhe provimet shkollore, si dhe ofrimin e ndihmës teknike komunave për të siguruar objekte shkollore të përshtatshme. Komunitetet janë përgjegjëse për ndërtimin e objekteve të arsimit dhe aftësimin, mirëmbajtjen e objekteve dhe pajisjeve arsimore, sigurimin e një mjedisi të shëndetshëm për nxënësit, dhe bashkëpunimin me prindërit dhe autoritetet e tjera publike. Në pjesën në gjuhën serbe, arsimi është nën përgjegjësinë e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit të Republikës së Serbisë, dhe asgjë nuk është e decentralizuar në përgjegjësi të komunave. Arsimi i lartë përbën një çështje hibride dhe nuk përfshihet në këtë raport, kështu që nuk do të jetë subjekt shqyrtimi i këtij studimi<sup>8</sup>.

Së pari, ky raport përbën një përpjekje për të adresuar mungesën e njohurive dhe transparencës sa i përket arsimimit në gjuhën serbe në Kosovë. Deri më tani nuk është bërë ndonjë studim që do të pasqyroste fushëveprimin e saktë të rrjetit të arsimit në gjuhën serbe në Kosovë. Një qëllim i dytë kryesor është që të nxjerrim në pah, nëpërmjet treguesve lehtësisht të matshëm, nevojat themelore të nxënësve, fëmijëve, mësimitdhënësve dhe institucioneve, me qëllim të përmbushjes së tyre me anë të politikave të hollësishme për avancimin e arsimimit që ofrohet në gjuhën serbe.

Ky raport jep informata faktike mbi kushtet aktuale të arsimit në gjuhën serbe në Kosovë. Në vlerësimin e të dhënave raporti nuk merret me organizimin politik të sistemit arsimor, studimi nuk kishte për qëllim shqyrtimin e pagave ose plan-programeve mësimore në shkolla, e as që të kontrollonte dhe shqyrtonte librat shkollorë, por merret vetëm me mënyrën e funksionimit të tij si bazë për veprim. Ai duhet konsideruar si dokument bazë informues në mbështetje të përmirësimit të cilësisë së arsimit në gjuhën serbe në Kosovë, si dhe për t'u ofruar politikë-bërësve, autoriteteve të Kosovës, atyre të Serbisë dhe BE- së si palë ndërmjetësuese informata të pasura dhe njohuri për të forcuar bashkëpunimin në mes të dy sistemeve. Masa të tilla janë të domosdoshme në mënyrë që të përmbushet nevoja për rritjen e përfaqësimit të komuniteteve jo-shumicë në sferën publike dhe në kuadër të shoqërisë civile e iniciativave ekonomike të sektorit privat. Kosova ka popullatën më të re në Evropë, gjë që nënkupton se rinia përbën kapital të rëndësishëm njerëzor për zhvillimin politik dhe ekonomik të vendit. Prandaj, arsimimi i duhur i pjesëtarëve të të gjitha komuniteteve është parakusht për qasje të barabartë në tregun e punës në zhvillimin e sektorit publik, krijimin e vendeve të punës dhe nxitjen e përfaqësimit të të gjitha komunave në sferën publike dhe atë civile.

---

<sup>7</sup> Ligji për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, neni 3: Parimet e përgjithshme: "Është obligim i përgjithshëm i Ministrisë, komunave, institucioneve arsimore dhe të gjitha organeve të tjera, të përfshira në ofrimin e arsimit parauniversitar, siç është rregulluar përmes këtij ligji dhe ligjeve të tjera në fuqi, që të planifikojnë dhe ofrojnë shërbime efikase, efektive, fleksibile, gjithëpërfshirëse dhe profesionale, të dizajnuara për t'u ofruar të gjithë fëmijëve të drejtat e barabarta për shkollim, në pajtim me aftësitë dhe nevojat e tyre specifike, si dhe për të avancuar zhvillimin e tyre arsimor e social."

<sup>8</sup> Ligji për Arsim në Komunitetet e Republikës së Kosovës, neni 14:

[http://www.gazetazrtare.com/e-gov/index.php?option=com\\_content&task=view&id=155&Itemid=56&lang=en](http://www.gazetazrtare.com/e-gov/index.php?option=com_content&task=view&id=155&Itemid=56&lang=en)

## 2. PROCESI DHE METODOLOGJIA

Ky raport bazohet në analizën e të dhënave që kanë të bëjnë me një numër të përzgjedhur të treguesve për matjen e cilësisë së arsimit në shkollat në gjuhën serbe në Kosovë. Të dhënat janë mbledhur përmes intervistave dhe pyetësorëve të kryer nga katër ekspertë me përfaqësues të shkollave fillore dhe të mesme dhe të Komunave.

### 2.1. Intervistat

Të dhënat përkatëse janë mbledhur përmes vizitave në të gjitha institucionet që ofrojnë arsim në gjuhën serbe në Kosovë dhe intervistave me personelin e shkollave. Ekipi i hulumtuesve tanë ka vizituar gjithsej 103 shkolla. Pjesa më e madhe e të intervistuarve janë drejtorë të shkollave (69); pastaj sekretarë të shkollave (10), psikologë të shkollave (7), shefa të kontabilitetit (2), si dhe një zëvendës-drejtor dhe një mësimdhënës. Intervistat janë kryer në takime; atyre që kanë preferuar vetëm të plotësojnë pyetësorin, pa u takuar, u është mundësuar kjo. Intervistat kanë qenë të një natyre të gjysmë-strukturuar, mbi bazën e një pyetësi të hartuar për mbledhjen e të dhënave sasiore e cilësore për të mundësuar një vlerësim të plotë të cilësisë dhe sfidave me të cilat ballafaqohet arsimimi në gjuhën serbe në Kosovë. Natyra gjysmë-strukturuar e intervistave gjithashtu mundëson krahasim. Megjithatë, pyetësi nuk është ndjekur në mënyrë rigoroze; hulumtuesit në terren e kanë shfrytëzuar atë si kornizë për dialog të hapur. Ata u kanë mundësuar të të intervistuarve të shprehin hapur mendimet dhe brengat e tyre personale lidhur me arsimimin në gjuhën serbe në Kosovë. Marrë parasysh natyrën e ndjeshme të temës, në pyetësorë nuk janë ngritur çështje që janë hapur politike, me qëllimin për të krijuar një mjedis të besueshëm ku të intervistuarit të mund të shprehnin mendimet dhe nevojat e tyre. Të intervistuarit kanë pasur të drejtë të ndërpresin intervistat në çfarëdo kohe, dhe anonimiteti ishte i garantuar.

### 2.2. Zhvillimi i matricave të treguesve bazuar në standardet e BE-së

Intervistat janë menduar ashtu që të ofrohen të dhëna që kanë të bëjnë me një numër të treguesve për një vlerësim në shumë aspekte të cilësisë së arsimit në gjuhën serbe në Kosovë.

Treguesit janë identifikuar përmes hulumtimeve të gjera paraprake në zyrë. Qëllimi ishte identifikimi i treguesve efektivë, të matshëm dhe të krahasueshëm. Në fund vendosëm të përzgjedhim 19 tregues cilësorë dhe sasiore. Ata bazohen në tregues të vendosur tashmë për një kohë të gjatë për vlerësimin e cilësisë së arsimit, të zhvilluar nga Komisioni Evropian<sup>9</sup>. Disa prej tyre janë marrë dhe përshtatur për këtë hulumtim: teknologjitë e informimit dhe komunikimit, pjesëmarrja e prindërve, dhe arsimimi e trajnimi i personelit mësimdhënës. Kriteret e tjera bazohen në rrethanat specifike të gjendjes së arsimit në Kosovë.

Matricat e treguesve janë kategorizuar në shtatë tema kryesore të hulumtimit: (a) vendndodhja dhe lloji; (b) informatat statistikore; (c) infrastruktura dhe objektet; (d) materialet mësimore dhe personeli mësimdhënës; (e) arritshmëria dhe normat e braktisjes; (f) puna me prindërit dhe komunitetin; (g) bashkëpunimi dhe shkëmbimet; (h) mbështetja e jashtme dhe/ose investimet; dhe (i) sfidat.

<sup>9</sup> Raporti Evropian për Cilësinë e Arsimit në Shkollë, Gjashtëmbëdhjetë Tregues të Cilësisë. Drejtorja e Përgjithshme për Arsim dhe Kulturë – Komisioni Evropian, 2000, <http://aei.pitt.edu/42406/1/A6503.pdf>

## **a. Vendndodhja dhe lloji**

Kjo kategori e treguesve vlerëson karakteristikat kryesore të shkollës: nivelin e arsimit të ofruar, vendndodhjen gjeografike të komunitetit të cilit i shërben dhe çfarëdo strukture të ndarë të vendosur në ndërtesa të tjera publike apo private. Ky tregues ndihmon për të monitoruar mbulimin dhe shtrirjen gjeografike të arsimit në gjuhën serbe në Kosovë. Një element tjetër që është vlerësuar në këtë kategori treguesish është distanca dhe lloji i transportit nga vendbanimet e nxënësve të shkollat dhe nëse shkollat ofrojnë transport të veçantë për nxënësit.

## **b. Informatat statistikore**

Ky grup i treguesve ofron informata sasiore, pra të dhëna të hollësishme statistikore të shkollave, të cilat kanë të bëjnë me numrin e nxënësve, madhësinë e klasave, proporcionin nxënës- mësimitdhënës/profesor dhe kohëzgjatjen e ditës së shkollës. Të dhënat janë ndarë sipas gjinisë dhe komunitetit. Vëmendje e veçantë i është kushtuar arsimit special për nxënësit që përballen me vështirësi në të mësuarit. Ky lloji i të dhënave më pas është krahasuar me treguesin (e) arritshmëria arsimore, me qëllimin për të vlerësuar çfarëdo mësimi të specializuar për këto kategori nxënësish.

## **c. Infrastruktura dhe objektet**

Me anë të këtij grupi treguesish është analizuar cilësia e infrastrukturës dhe objekteve. Treguesit veçanërisht kanë mundësuar mbledhjen e të dhënave mbi madhësinë dhe kushtet e objekteve shkollore, mobilet, objektet brenda/jashtë ndërtesave shkollore, hapësirat shtesë të dedikuara për aktivitete të veçanta (si qendrat rinore, sallat për ushtrime fizikure, laboratorët), dhe objektet ku shërbehet ushqim. Për të kompletuar këto informata, hulumtuesit kanë vizituar objektet shkollore ku kanë parë kushtet dhe kanë listuar objektet brenda tyre.

## **d. Materialet mësimore dhe personeli mësimitdhënës**

Një vlerësim relevant për cilësinë e arsimit përfshin analizën e gjendjes fizike dhe cilësisë së materialeve mësimore, si dhe nëse materialet e ofruara janë të mjaftueshme për të mbuluar plan-programin mësimor. Ky grup i treguesve gjithashtu shqyrton përdorimin e teknologjisë – veçanërisht kompjuterëve – në procesin mësimor. Vëmendje i është kushtuar edhe zhvillimit profesional të personelit mësimitdhënës, veçanërisht ofrimin të trajnimeve dhe inkurajimit të krijimit të rrjeteve ndërmjet mësimitdhënësve. Pyetësori përfshinte një pyetje konkrete lidhur me kurset e trajnimit, kushtet dhe tipologjitë e tyre (pedagogjike ose sipas lëndëve mësimore).

## **e. Arritshmëria dhe normat e braktisjes**

Arritshmëria dhe normat e braktisjes përbëjnë një kategori themelore të standardeve evropiane të vlerësimit, pasi që tregojnë kapacitetin e shkollave për të arritur me sukses të tërë popullsia e moshës shkollore, përfshirë pjesëtarët e grupeve të cënueshme. Treguesit në këtë fushë kanë përfshirë mesataren e suksesit të nxënësve, normat e ndjekjes së mësimit dhe braktisjes së tij dhe nxënësit që vazhdojnë shkollimin.

#### **f. Puna më prindërit dhe komunitetin**

Shkolla luan rol të rëndësishëm brenda komunitetit, si drejtpërsëdrejti, nëpërmjet përfshirjes së prindërve dhe përfaqësuesve të tjerë të komunitetit, ashtu edhe tërthorazi, si institucion i rëndësishëm shoqëror. Kjo kategori e treguesve ofron të dhëna mbi themelimin e këshillave ose organeve të tjera të prindërve dhe rolin shoqëror të shkollës brenda komunitetit.

#### **g. Bashkëpunimi dhe shkëmbimet**

Ky grup treguesish analizon shpeshësinë dhe llojet e bashkëpunimit apo shkëmbimeve me shkolla të tjera në gjuhën serbe dhe ato jo-serbe.

#### **h. Mbështetja e jashtme dhe/ose investimet**


Këta tregues analizojnë sasinë dhe llojin e përkrahjes dhe investimeve që bëhen në shkolla përveç financimit nga qeveria.

#### **i. Sfidat**

Kjo pjesë përbën pyetjet përfundimtar të hapura të pyetësorit, duke i dhënë të intervistuarve mundësinë për të adresuar lirisht çfarëdo sfide të veçantë për të ardhmen. Marrë parasysh qëllimin e hulumtimit, kjo pyetje është shumë e rëndësishme për të analizuar peshën dhe rëndësinë që u jepet nevojave dhe kërkesave të veçanta nga stafi brenda vetë shkollave.

### 3. TË GJETURAT KYÇE DHE VLERËSIMI I TREGUESVE

#### a. Vendndodhja dhe lloji



Diagrami 3.1

Shumica e shkollave që ofrojnë arsimim në gjuhën serbe në Kosovë janë shkolla fillore (69). Rajoni me numrin më të madh të shkollave në gjuhën serbe është Mitrovica/Mitrovica, me 34 shkolla në këtë gjuhë – 16 prej tyre në qytetin e Mitrovica/Mitrovicës; ndërsa me pas vjen Priština/Prishtina (29) dhe Gnjilane/Gjiilan (22). Mbulimi më i madh është në pjesën veriore dhe atë lindore të vendit, ku jetojnë më së shumti pjesëtarë të komunitetit serb. Ekzistojnë 34 shkolla të mesme dhe shumica e tyre gjenden në komunat kryesore me shumicë serbe: Mitrovica/Mitrovicë, Leposavić/Leposaviq, Štrpce/Shtërpçë dhe Gračanica/Graçanicë. Katër shkolla të mesme në rajonin e Peç/Pejës (Goraždevac/Gorazhdevc ) dhe at të Prizrenit (Dragaš/Dragash) përbëjnë përjashtim nga kjo.

Në shumicën e rasteve ofrohet transport për në shkollë, sidomos për nxënësit të cilët duhet të udhëtojnë më shumë se 3-4 km. Megjithatë, cilësia e transportit në përgjithësi është shumë e dobët. Në pjesën jugore të Kosovës, sidomos në rajonin e Gorës dhe atë të Štrpce/Shtërpçës, një numër i vogël autobusësh mbulojnë 20-30 fshatra çdo mëngjes për të transportuar nxënësit. Gjendja përkeqësohet gjatë dimrit, për shkak të mungesës së karburantit, vonesave dhe acarit. Në disa raste nxënësit duhet të zgjohen rreth orës 5 të mëngjesit për të zënë autobusin. Kjo rutinë ndikon negativisht në suksesin e tyre dhe ndikon në rezultate të dobëta arsimore.

Megjithatë, ka disa shembuj kur edhe nëse ka autobusë të shkollave në dispozicion, nxënësit preferojnë të ecin ose dërgohen në shkollë me transport privat. Në rastet kur transporti publik nuk është i rregullt ofrohet transport privat, për arsye sigurie. Në rastet kur distanca është më e vogël se 2 km zakonisht nuk ofrohet transport për në shkollë. Duhet të përmenden tri përjashtime nga kjo:

- Shkolla Fillore “9 Maji” në fshatin Rašča/Rapçë të rajonit të Gorës nuk ofron transport, për shkak të burimeve të pamjaftueshme financiare. Marrë parasysh distancën e dukshme për shumë nxënës (rreth 3 km), drejtori i shkollës transporton një numër të nxënësve në shkollë me veturën e tij private.
- Në Mitrovica/Mitrovicë, shkolla “Kosovski Bozhur” për nxënës me nevoja të veçanta gjendet deri në 20 km larg nga vendbanimet e nxënësve. Megjithatë, ajo nuk ofron transport të veçantë.
- Në Zvečan/Zvečan, Shkolla Fillore “Vuk Karaxhiq” nuk posedon ndonjë autobus për transportimin e nxënësve edhe pse distanca deri në shtëpitë e nxënësve në disa raste është rreth 7 km.

Paralelet e ndara përbëjnë një fenomen shumë të zakonshëm në sistemin arsimor të Serbisë. Numri i tërësishëm i këtij lloji klasash në shkollat në gjuhën serbe në Kosovë është 141. Ndërtesat amë të këtyre paraleleve gjenden në qendrat e komunave, por për të lehtësuar qasjen në arsim për nxënësit që banojnë më larg nga qendrat, këto struktura të ndara që zakonisht mbulojnë klasat 1 – 4, gjenden në fshatra të vogla. Paralelet e ndara janë të shpërndara kryesisht në rajonet jugore, ku pjesëtarë të komunitetit serb janë më të izoluar nga qendrat e komunave. Rastet më të rëndësishme të kësaj kategorie janë: shkolla fillore në fshatin Goraždevac/Gorazhdevc, me 12 klasa të veçanta; në Štrpcë/Shtërpçë rreth 327 nxënës ndjekin mësimin në 12 klasa të zhvendosura si paralele të ndara; në rajonin e Gnjilane/Gjilanit përafërsisht një mijë nxënës ndjekin mësimin në klasa të vendosura jashtë ndërtesave amë. Pothuajse të gjitha paralelet e ndara gjenden në hapësira publike.

### Shkolla “5 Tetori” në Globočica/Glloboçicë, Gorë


Kjo shkollë mund të merret si një rast tipik për studimin e gjendjes në shumë shkolla në rajonin e Gorës. Ajo përballet me mungesë serioze të hapësirës, gjë që pengon aktivitetet normale arsimore dhe zhvillimin. Për të siguruar respektimin e orarit, nxënësit në këtë shkollë janë të ndarë në tri ndërrime të ndryshme. Drejtori ka theksuar nevojën për të zgjeruar objektin e shkollës. Përveç kësaj, nuk ka banka dhe karrige të mjaftueshme për të gjithë nxënësit, gjë që shkakton probleme serioze. Objektet sanitare kanë nevojë për renovim. Për fat të keq nuk është e pazakontë për shkollat në këtë rajon që të kenë tualete jashtë objekteve shkollore.

## b. Informatat statistikore

Në këtë pjesë analizojmë numrin e nxënësve që ndjekin arsimin në gjuhën serbe, me një vështrim të përgjithshëm sasior të madhësisë së klasave, proporcionit nxënës – mësimdhënës/profesor, orët mësimore dhe numrin e nxënësve në arsimimin special. Të dhënat janë të ndara sipas gjinisë dhe përkatësisë etnike.<sup>10</sup>

<sup>10</sup> Gjatë studimit, katër shkolla në rajonin e Priština/Priştinës nuk kanë ofruar asnjë informatë: Shkolla Bujqësore dhe Gjinnazi në Lipjan/Lipjan dhe Shkolla Fillore “Sveti Sava”, në Shushicë dhe Obilić/Obiliq.

## 2. Numri i nxënësve sipas gjinisë



Diagrami 3.2


Numri i nxënësve që ndjekin shkollimin në gjuhën serbe përgjithësisht pasqyron madhësinë e komunitetit serb në rajonin përkatës. Balanca gjinore është relativisht e barabartë edhe nëse përjashtojmë shkollat teknike, në të cilat ka më shumë nxënës se nxënëse. Në Shkollën e Mesme Elektro-Teknike "Milladin Popoviq" në Gračanica/Graçanicë mësimin e ndjekin gjithsej 138 nxënës dhe vetëm 4 nxënëse. Në Shkollën e Mesme Ekonomike dhe të Turizmit në fshatin Mlika/Mlikë, në rajonin e Gorës, përqindja e nxënësve në raport me nxënëset është 3 me 1. Në Mitrovica/Mitrovicë, Instituti Teknik dhe Shkolla Teknike "Mihajlo Petroviq Allas" numëron vetëm 25 nxënëse nga gjithsej 278 nxënës të të dy gjinive. Nga ana tjetër, shumica e nxënësve në shkollat mjekësore janë zakonisht të gjinisë femërore. Rast që e ilustron këtë është ai i shkollës së Mjekësisë me konvikt për nxënës, në Mitrovica/Mitrovicë, ku mësimin e ndjekin 367 nxënëse dhe 16 nxënës<sup>11</sup>.

Diagrami i tretë me shirita tregon numrin e nxënësve të përkatësive etnive jo-serbe që ndjekin shkollimin në gjuhën serbe në Kosovë. Sipas pyetësorëve, vetëm një nxënës shqiptar ndjek mësimin në gjuhën serbe, në Shkollën Filllore "Veljko Dugosheviq", në Ranilug/Ranillug. Në veçanti bie në sy minoriteti rom në shkollat në gjuhën serbe, me gjithsej rreth 831<sup>12</sup> nxënës në nivelin fillor dhe 83 në atë të mesëm, të përqendruar kryesisht në komunat e Gnjilane/Gjilanit, Gračanica/Graçanicës, Mitrovica/Mitrovicës, Kamenica/Kamenicë dhe Vuçitrn/Vushtrrisë.

<sup>11</sup>. Siç u përmend në diagram, disa të dhëna nuk mund të kategorizohen sipas gjinisë, pasi që 4 shkolla nuk kanë ofruar të dhëna mbi gjininë e nxënësve (Shkolla Teknike "Dragi Popoviq" në Gnjilane/Gjilan, "Dimitrije Prica" në Priština/Prishtinë, "Nikolla Tesla" në Leposavić/Leposaviq, dhe Shkolla Filllore "Milun Jakshiq" në Srbica/Skënderaj).

<sup>12</sup>. Dy shkolla fillore në Mitrovica/Mitrovicë ("Predrag dhe Miodrag Mihajloviq", dhe "Desanka Maksimoviq"), në të cilat mësimin e ndjekin vetëm nxënës romë, nuk kanë ofruar informata mbi numrin e nxënësve.

### 3. Numri i nxënësve nga komunitetet jo-shumicë




Diagrami 3.3

Duhet përmendur dy shkolla në Gračanica/Graçanicë dhe në Mitrovica/Mitrovicë për numrin e madh të fëmijëve romë. Në Shkollën Filllore "Milladin Mitiq" në Gračanica/Graçanicë janë të regjistruar 111 nxënës romë, nga gjithsej 456 sa ka shkolla. Në shkollën "Dositej Obradović" në Mitrovica/Mitrovicë mësimin e ndjekin vetëm nga nxënës romë (85), si dhe në dy shkolla filllore, "Predrag dhe Miodrag Mihajloviq" dhe "Desanka Maksimović", të cilat nuk kanë ofruar të dhëna mbi numrin e nxënësve. Nxënës të komunitetit goran ndjekin mësimin në pesë shkolla në rajonin e Gorës, me gjithsej 593 nxënës. Goranë gjithashtu ndjekin mësimin në gjuhën serbe në rajonin e Mitrovica/Mitrovicës. Edhe një numër i konsiderueshëm i nxënësve boshnjakë, gjithsej 77, ndjekin mësimin në gjuhën serbe në rajonin e Mitrovica/Mitrovicës. Në Shkollën Filllore "Sveti Sava" mësimin e ndjekin 22 nxënës boshnjakë, prej gjithsej 817 nxënësve. Arsyet pse nxënësit nga komuniteti boshnjak zgjedhin të ndjekin shkollimin në gjuhën serbe, e jo në shkollat në gjuhën boshnjake, janë kulturore dhe gjeografike. Në disa raste ata nuk kanë mundësi të tjera, pasi që shkollat në gjuhën boshnjake janë shumë larg. Në raste të tjera, ata preferojnë të ndjekin mësimin në shkolla në gjuhën serbe për shkak të skepticizmit për të ardhmen e tyre profesionale në Kosovë, ose si qasje të natyrshme të respektimit të zakoneve me të cilat janë mësuar. Krejt në fund, një numër shumë i vogël i përfaqësuesve të grupeve të tjera etnike ndjekin mësimin në shkollat e Kosovës në gjuhën serbe, kryesisht në Mitrovica/Mitrovicë dhe në Gračanica/Graçanicë. Në këtë studim është vënë re në veçanti rasti i tre kroatëve, një malazezit, një turkut dhe një çekut. Në komunën e Lipjan/Lipjanit, ku graviton fshati Janjevo/Janjevë, ku jetojnë shumica e kroatëve, në Shkollën "Vladimir Nazor" mësimin e ndjekin 24 nxënës të komunitetit kroat.



#### 4. Numri mesatar i nxënësve për një mësuesdhënës



Diagrami 3.4

#### Në fokus: rënia e numrit të nxënësve

Në rajonin e Peć/Pejës dhe atë të Gorës vjen në pah mungesa e nxënësve. Arsyeja kryesore është emigrimi ose zhvendosja në komunat me shumicë serbe. Në këto rajone shkollat janë të shpërndara nëpër fshatra të largëta dhe në to mësimin e ndjekin vetëm nga disa fëmijë. Këto shkolla përballen me rrezik serioz të mbylljes, për shkak të mungesës së nxënësve dhe burimeve financiare.

Ngjashëm, në disa shkolla në Gnjilane/Gjiilan mësimin e ndjekin nga më pak se 20 fëmijë. Ky është rasti me dy shkolla fillore: "Branko Radiçević" dhe "9 Maji", në Kamenica/Kamenicë. Megjithatë infrastruktura e të dy këtyre shkollave është në kushte shumë të këqija, sfida kryesore e përmendur nga të intervistuarit është mungesa e nxënësve. Pasoja kryesore e një numri të vogël të fëmijëve të regjistruar është e ardhmja e pasigurt për këto shkolla, të cilat rrezikojnë të mbyllen. Siç dëshmohet nga kjo anketë, rënia e numrit të nxënësve përbën një problem të rëndësishëm për shkollat në gjuhën serbe.

Mesatarja evropiane për numrin e nxënësve për një mësuesdhënës/profesor është 14:1 për shkollat fillore dhe 12:1 për shkollat e mesme. Të dhënat për shkollat në gjuhën serbe në Kosovë tregojnë se ky proporcion është qartazi nën mesataren evropiane. Gjysma e shkollave fillore dhe 72% e shkollave të mesme kanë mesatarisht më pak se 5 nxënës për një mësuesdhënës/profesor. Shpjegimi qëndron në numrin e madh të paraleleve të ndara nga objektet kryesore, të cilat kanë personelin e tyre mësuesdhënës, por shpesh pak nxënës. Përveç kësaj, numri i mësuesdhënësve/profesorëve nuk varet nga numri i përgjithshëm i nxënësve, por nga lëndët që mësohen. Prandaj, edhe nëse një klasë ka pak nxënës, numri i mësuesdhënësve/profesorëve varet nga numri i lëndëve që japin.

Madhësia mesatare e klasave korrespondon me kapacitetin e shkollës. Për shkollat ku mësimin e ndjekin nga më pak se 50 nxënës, klasat kanë shumë pak nxënës – 3 deri në 7 fëmijë. Në shkollat me mbi 50 nxënës klasat përbëhen nga 7 deri në 15 nxënës. Në rastin e instituteve më të mëdha, me mbi 250 nxënës, klasat përbëhen nga rreth 25 – 30 nxënës. Numri më i vogël i nxënësve për një mësimdhënës/profesor është regjistruar në rajonet Uroševac/Ferizaj, Peć/Pejë dhe Gnjilane/Gjilan, ku nuk është e pazakontë të gjesh shkolla fillore me mesatarisht më pak se një nxënës për një pjesëtar të personelit mësimdhënës.

Sa i përket gjatësisë mesatare të ditës së shkollës, nuk ka raste të veçanta për t'u theksuar. Në përgjithësi, kohëzgjatja mesatare e një dite shkollore është mes 4 dhe 6 orësh për të gjitha shkollat në gjuhën serbe në Kosovë. Shumë shkolla e organizojnë mësimin në ndërrime të mëngjesit dhe të pasdites, për shkak të mungesës së hapësirës. Në disa raste, shkollat duhet t'ia dalin me deri në tre ndërrime në ditë, veçanërisht në rajonet në pjesën jugore.

Shkollat speciale, për nxënës me nevoja të veçanta sa i përket të mësuarit, gjenden në Mitrovica/Mitrovicë, Leposavić/Leposaviq dhe Gračanica/Graçanicë. Shkolla "Kosovski Bozhur" në Mitrovica/Mitrovicë numëron 46 nxënës me nevoja të veçanta. Shkolla "Leposavić/Leposaviq" në Leposavić/Leposaviq ka 30 nxënës me nevoja të veçanta. Në Gračanica/Graçanicë, nxënësit me nevoja të veçanta ndjekin mësimin në shkollën "Kralj Millutin" dhe atë "Knez L Lazar", me nga 5 nxënës në secilën prej tyre.

### c. Infrastruktura dhe objektet

Një problem i veçantë me të cilat përballen shkollat në gjuhën serbe në Kosovë është se shumë prej tyre shfrytëzojnë objekte që nuk janë ndërtuar të destinuara për arsim ose që në nevojë urgjente për rinovim dhe investime. Një çështje e lidhur me këtë është se në shumë raste shkollat e mesme që kanë qenë në qendrat më të mëdha të qyteteve para luftës së viteve 1998-1999 janë zhvendosur në objekte më të vogla të shkollave fillore në periferi të qyteteve, ku shpesh nuk ka infrastrukturë apo hapësirë adekuate. Për shembull, shkolla e mesme për mekanikë të automjeteve në Gračanica/Graçanicë është zhvendosur nga Priština/Prishtina (ku ka qenë para luftës), në ndërtesën e Shkollës Fillore "Kralj Millutin". Për pasojë, kjo shkollë fillore nuk ka hapësirë të mjaftueshme për 684 nxënësit e saj dhe mësimi duhet të organizohet me ndërrime.


Rasti më alarmant është raportuar në Mitrovica/Mitrovicë, ku katër shkolla dhe dy fakultete duhet të ndajnë të njëjtin objekt. Një rast i ngjashëm është ai i Gjimnazit në Šilovo/Shillovë, i cili është zhvendosur nga Gnjilane/Gjilani, Shkollës së Lartë Elektro-Teknike dhe Fakultetit të Mjekësisë, të cilat janë zhvendosur nga Priština/Prishtina në Gračanica/Graçanicë, dhe Shkollës Ekonomike dhe të Turizmit, e cila është zhvendosur nga Dragaš/Dragashi në objektin e shkollës fillore në fshatin Mlike/Mlikë.

Rasti më alarmant është me dy shkolla fillore në Mitrovica/Mitrovicë ("Predrag dhe Miodrag Mihajloviq" dhe "Desanka Maksimoviq"), ku mësimin e ndjekin nxënës të komunitetit rom. Këto dy shkolla shfrytëzojnë objektin e shkollës "Sveti Sava".

## Shkolla fillore dhe ajo e mesme në Orahovac/Rahovec


Rasti i kësaj shkolle është shumë alarmant. Shkolla fillore dhe gjimnazi ndajnë të njëjtin objekt, ashtu si shumë shkolla të tjera të përmendura. Megjithatë, shqetësimi më i madh nuk është mungesa e hapësirës, por hapësira joadekuade dhe struktura e ndërtesës. Qëllimi parësor i saj, kur ishte ndërtuar, nuk ishte që të shërbente si objekt për qëllime mësimore, por për aktivitete kulturore. Në të mungojnë mobilet dhe është krejt i papërshtatshëm për aktivitete mësimore. Kjo shkollë nuk posedon shesh lojërash ose oborr ku mund të luajnë fëmijët. Ngrohja bëhet me shporete të vjetër, me lëndë djegëse të forta. Kjo shkollë nuk posedon ndonjë laborator, kabinete, sallë sportesh, pasi që objekti as nuk është projektuar që të ketë klasa.

Sa i përket qasjes në objektet shkollore, gjendja arsimore dallon shumë kur krahasohen shkollat në katër komunat në veri të Kosovës me shkollat që gjenden në pjesën në jug të Ibrit. Shkollat në veri zakonisht kanë infrastrukturë më të mirë dhe pajisje ndihmëse për qasje në objekte sesa ato që gjenden në pjesët të tjera të Kosovës. Ky dallim shpjegohet me investimet dhe mbështetja e drejtpërdrejtë nga Republika e Serbisë. Diagrami në vijim paraqet objektet mbështetëse në dispozicion të shkollave në gjuhën serbe.




Diagrami 3.6

## 6. Proporcioni i objekteve për një shkollë Qendër



Diagrami 3.7

## 6. Proporcioni i objekteve për një shkollë Juglindje



Diagrami 3.8

Për të ofruar një pasqyrë të plotë të shpërndarjes së objekteve shkollore brenda vendit, diagramet fokusohen në tri zona gjeografike: në veriperëndim (Mitrovica/Mitrovicë dhe Peć/Pejë), qendër (Priština/Prishtinë), dhe në juglindje (Uroševac/Ferizaj, Gnjilane/Gjilan, Prizren). Analiza bazohet në një qasje "negative", duke identifikuar së pari mangësitë e vazhdueshme dhe që përsëriten lidhur me objektet dhe infrastrukturën. Laboratorët shkencorë, kabinetet, mensat, objektet parashkollore dhe qendrat rinore janë objekte më të rralla. Rajoni me shkolla të pajisura më pak del të jetë ai i Prizrenit, në jug. Mungesa e mensave në shkolla arsyetohet nga kohëzgjatja mesatare të ditës së shkollës, e cila nuk kalon më shumë se 5 deri në 6 orë. Shkollat me konvikte, si Shkolla e Mjekësisë në Mitrovica/Mitrovicë, kanë mensa të veçanta, të cilat janë në gjendje shumë të mirë. Megjithatë, e njëjta shkollë nuk ka asnjë laborator shkencor, që janë thelbësorë për të arritur rezultate të të mësuarit. Ka vetëm pak qendra rinore që janë aktive në Kosovë, dhe të gjitha gjenden në rajonin e komunës së Mitrovica/Mitrovicës.

Sa u përket objekteve të tjera të vlerësuara, hapësirat në natyrë përbëjnë një shqetësim të përsëritur për shkollat fillore, ku fëmijët kanë nevojë për hapësirë të duhur për të luajtur. Disa shkolla nuk kanë as hapësira të duhura për lojëra ose nuk janë të rrethuara në mënyrë të sigurt. Gjatë vizitave hulumtuesit kanë evidentuar raste ku dhomat për veshje gjenden jashtë objekteve shkollore, veçanërisht në rastin e shkollës "Dostelj Obradović" në Novo Brdo/Novobërdë dhe atë të shkollës "Bllagoje Radiq" në Zubin Potok. Ankesat e vazhdueshme nga të intervistuarit tregojnë se hapësirat duhet të rinovohen dhe të ndërrohen mobilet. Mungesa e tualeteve brenda ndërtesave gjithashtu përbën shqetësim serioz. Në rajonin e Gorës ka nevojë tepër urgjente për rinovime dhe përmirësimin e kushteve higjienike.

Shpërndarja e pajisjeve të TI-së, të cilat zënë një vend gjithnjë e më të rëndësishëm në arsimimin bashkëkohor, dallon shumë nga rajoni në rajon. Shkollat në komunat Priština/Prishtinë, Mitrovica/Mitrovicë dhe Gnjilane/Gjilan duket të jenë më së miri të pajisura me kompjuterë. Shkollat në Uroševac/Ferizaj dhe Peć/Pejë posedojnë shumë pak kompjuterë, ku hyjnë edhe raste me vetëm nga një kompjuter për një shkollë ("Dositelj Obradović" dhe "Radosh Tosiq" në komunën Istok/Istog). Megjithatë, edhe në rajonin e Mitrovica/Mitrovicës, ku pajisja me pajisje të TI-së përgjithësisht vlerësohet të jetë e përshtatshme, ka disa raste të mungesës dramatike të kompjuterëve. Shkolla e Mesme Bujqësore në Lešak/Leshak posedon vetëm 8 kompjuterë për gjithsej 150 nxënës. Instituti primar dhe sekondar "Miodrag Vasiljeviq" në Mitrovica/Mitrovicë posedon vetëm 3 kompjuterë për mbi 300 nxënës.

Gjatë vlerësimit të disponueshmërisë dhe cilësisë së infrastrukturës për kurset teknike me kërkesa të veçanta infrastrukturore, siç janë laboratorët shkencorë dhe sallat me kompjuterë, hulumtuesit në terren kanë raportuar mungesë të infrastrukturës adekuate, madje edhe në institute të specializuara në këto fusha. Gjendja në shkolla të tilla është si në vijim:

- Shkolla Teknike në Gnjilane/Gjilan posedon një sallë kompjuterësh, e cila ka kabinet kompjuterësh, por jo edhe laborator shkencor. Për më tepër, kjo shkollë shfrytëzon objektet e Shkollës Fillore "Petar Petroviq".
- E njëjta gjendje është në Shkollën e Mesme të Mjekësisë, të Priština/Prishtinës, që gjendet në Preoce/Preoc, e cila nuk posedon laborator shkencor.
- Shkolla e Bujqësisë në Leposavić/Leposaviq ka nevojë serioze për përmirësimin e pajisjeve mësimore, konkretisht për resurse të të mësuarit (traktorë dhe kamionë), tokë për të kryer praktikë dhe oborr të rrethuar me gardh.
- Shkolla Ekonomike në Gorazdevac/Gorazhdevc nuk ka sallë kompjuterësh.
- Shkolla Teknike "Nikolla Tesla" në komunën e Vučitrn/Vushtrrisë nuk ka kabinet kompjuterësh as laborator shkencor.

- Duhet përmendur shkollën “Kosovski Bozhur” për nxënësit me nevoja të veçanta, në Mitrovica/Mitrovicë, për shkak të mungesës së konsiderueshme të pajisjeve të nevojshme për lëndën e biologjisë dhe një salle ndijore, për qëllime edukative.
- Shkolla e Mjekësisë në Ranilug/Ranillug ka përmendur nevojën për furnizim me pajisje të një laboratorit shkencor.

#### d. Kuadri mësimdhënës dhe materialet mësimore

Kuadri mësimdhënës në shkollat në gjuhën serbe përbëhet kryesisht nga banorë të lokaliteteve ose që vijnë nga komuna të tjera brenda Kosovës. Rajonet me një prani të konsiderueshme të personelit arsimor nga jashtë Kosovës (zakonisht nga fshatrat e Serbisë që gjenden në kufi me Kosovën) janë: (a) Priština/Prishtina (në veçanti Gračanica/Gračanica dhe Kosovo Polje/Fushë-Kosova), (b) Gnjilane/Gjilani (konkretisht Kamenica/Kamenica dhe Ranilug/Ranillugu), (c) Uroševac/Ferizaj dhe (d) komuna e Mitrovica/Mitrovicës.

Cilësia e trajnimit të personelit mësimdhënës dhe iniciativave në këtë drejtim konsiderohet e kënaqshme në të gjitha shkollat. Aktivitetet e vazhdueshme dedikuar përmirësimit të shkathtësive të mësimdhënësve/profesorëve janë kryesisht punëtoritë e përbashkëta në kuadër të administratës së shkollës ose në bashkëpunim me shkolla të tjera. Në një numër të madh rastesh, pjesëtarët e personelit mësimdhënës ndjekin punëtori të organizuara nga Ministria e Serbisë. Gjithashtu ofrohen trajnime dhe seminare profesionale: kryesisht për teknologji të TI-së dhe gjuhë angleze. Në rastin e shkollës për nxënësit me nevoja të veçanta në Mitrovica/Mitrovicë, ky institucion ofron punëtori për shkencën e arsimimit special. Në përgjithësi, shpeshësia dhe cilësia e këtyre iniciativave varet nga madhësia e shkollave. Kështu, në komuna të vogla si Parteš/Partesh, Vitina/Vitia dhe Klokot/Kllokoti, dhe në rajonin e Gorës, nuk organizohen programe shtesë trajnime ose kurse për personel mësimdhënës, për shkak të mungesës së resurseve.

#### **Shkolla e Mesme Teknike “Nikolla Tesla”, në Vuçitrn/Vushtrri**

Shkolla Teknike ndan hapësirat për mësim me Shkollën Fillore “Vuk Karaxhiq”. Drejtori është ankuar për mungesën e dokumenteve mbështetëse, revistave peridote dhe teksteve nga Ministria e Serbisë të cilat janë thelbësore për një proces të plotë arsimor. Sa i përket objektit, kjo shkollë nuk ka kushte të përshtatshme higjienike. Tualetet gjenden jashtë objektit shkollor dhe shfrytëzohen si tualete publike. Nuk ka as laboratorë.

Shumica e të intervistuarve kanë përmendur mungesën e materialeve mësimore. Problemi i shpërndarjes dhe importimit të teksteve shkollore nga Serbia për shkollat dhe nxënësit në Kosovë të cilët ndjekin mësimin me plan-programe të Republikës së Serbisë është i rëndësishëm. Vendimet e të dy Qeverive, të Kosovës dhe të Serbisë, kanë bërë që rreth 26,000 nxënës, në shekullin e XXI, në zemër të Evropës, të përballen me problemin e mungesës së teksteve shkollore, pra ata të drejtat njerëzore dhe të pakicave të të cilëve janë politizuar. Këto masa kanë prekur rreth 18,000 nxënës të përkatësisë etnike serbe në Kosovë të cilët ndjekin mësimin me plan-programe të Republikës së Serbisë, si dhe rreth 8,000 nxënës të përkatësisë etnike shqiptare në komunat e Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës, në Serbinë jugore.

Avokati i Popullit në Kosovë, Hilmi Jashari, ka thënë se Konventa Evropiane për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare ofron zgjidhjen më të mirë për këtë problem.

“Është e nevojshme që të ketë qasje më aktive të shtetit në përpjekjet për të siguruar të drejtën për arsimim, dhe kjo ka të bëjë me Beogradin dhe Prishtinën. Jo rastësisht kam përmendur Konventën Kornizë për Mbrotjtjen e Pakicave Kombëtare, pasi që kjo është referenca më e saktë si standard ndërkombëtar që duhet të zbatohet në këtë situatë. Tani çështja e vetme është nëse ekziston vullneti politik për këtë?!” tha Jashari në konferencën mbi problemet e shpërndarjes dhe importimit të teksteve shkollore nga Serbia për shkollat dhe nxënësit në Kosovë të cilët ndjekin mësimin me plan-programe të Republikës së Serbisë.<sup>13</sup>

Ligji për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës<sup>14</sup> përcakton, lidhur me arsimimin në gjuhën serbe, se shkollat që japin mësim në gjuhën serbe mund të shfrytëzojnë plan-programe dhe tekste shkollore të hartuar nga Ministria e Arsimit e Republikës së Serbisë, pas njoftimit të MASHT-it. Nëse MASHT nuk kundërshton këtë brenda 3 muajve pas njoftimit, materiali i tillë mund të përdoret. Shqyrtimi i këtyre materialeve i është besuar një Komisioni të Pavarur, i cili duhet të sigurojë që plan-programet dhe tekstet e prodhuara në Republikën e Serbisë nuk përmbajnë ndonjë njësi mësimore që nuk është në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Kjo nënkupton se plan-programet dhe tekstet shkollore nuk duhet të jenë në kundërshtim me konceptin e shumë-etnicitetit në Kosovë, nuk duhet të nxisin urrejtje dhe nuk duhet t'i referohen Kosovës ndryshe nga “Republika e Kosovës”.

Problemi i shpërndarjes së teksteve më së shumti ndikon në shkollat që gjenden në pjesën jugore të vendit. Ato kryesisht kanë përmendur tekstet shkollore dhe mjetet elementare të nevojshme për punë, si hartat gjeografike, tabelat për klasa dhe kompjuterët. Përveç kësaj, në shkollat në pjesën jugore shpesh mungojnë kabinetet për lëndë specifike. Për shembull, marrë parasysh rëndësinë e kompjuterëve për shkolla teknike apo ekonomike, kjo përbën një nga problemet kryesore për shkollat në gjuhën serbe. Ngjashëm, në rastin e shkollave të mesme profesionale, mungesa e materialeve të dedikuara për lëndët praktike përbën një pengesë serioze për procesin e të mësuarit.

#### e. Arritshmëria dhe normat e braktisjes

Të gjitha institucionet e analizuar në këtë studim përdorin një metodë standarde të vlerësimit: një provim përfundimtar ose një test të regjistrimit. Shkolla e mesme çdoherë përfundon me provimin e maturës, në të cilin hyhet në moshën 18-19-vjeçare. Shumë të intervistuar kanë pohuar se rezultatet e testit shkollën e tyre janë mesatare ose mbi mesataren.

Shumica e shkollave kanë norma shumë të mira të ndjekjes së shkollës / norma të ulëta të braktisjes (norma të ndjekjes nga 95% deri në 100%). Ka vetëm disa raste të normave të ndjekjes nën 90%, si është rasti me Shkollën Elektro-Teknike në Gračanica/Graçanicë, Shkollën Teknike “Nikolla Tesla” në komunën e Leposaviç/Leposaviqit dhe Shkollën Ekonomike në komunën e Mitrovica/Mitrovicës. Norma më të ulëta të ndjekjes dhe norma më të larta të braktisjes në përgjithësi ka në shkollat e mesme, sikur në të gjitha rastet e tjera. Sipas anketave, numri i fëmijëve që braktisin shkollimin në fazë të hershme nuk tejkalon 5%, gjë që është dukshëm nën mesataren evropiane (e cila arrin në rreth 10.7%<sup>15</sup>). Ka vetëm dy shkolla me norma të braktisjes prej 10% në arsimimin në gjuhën serbe në Kosovë: Shkolla Fillore “22 Dhjetori” në Gorë dhe Shkolla Ekonomike dhe Tregtisë në Prizren.

<sup>13</sup>. UDŽBENICI NA KOSOVI: LOKALNI PROBLEM - REGIONALNA PRAKSA

<http://www.ngoaktiv.org/srb/news/textbooks-issue-local-problems-regional-practices>

<sup>14</sup>. Law on Education in the Municipalities of Kosovo, Art. 12.

<sup>15</sup>. [http://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php/Europe\\_2020\\_indicators\\_-\\_education](http://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php/Europe_2020_indicators_-_education)



Megjithatë, dallim nga kjo gjendje bëjnë në veçanti dy shkolla, respektivisht dy shkolla fillore në Mitrovica/Mitrovicë ku mësimin e ndjekin nxënës të komunitetit rom, të cilat kanë raportuar norma alarmante të braktisjes. Konkretisht, shkolla "Predrag dhe Miodrag Mihajloviq" ka normë të braktisjes prej 50% dhe normë të ndjekjes prej 70%. Arsyeja e kësaj është emigrimi dhe përfshirje e vështirë e të kthyerve në shoqëri.

Kategoria e fundit e arritshmërisë arsimore që duhet të merret parasysh janë kushtet për avancimin e nxënësve me nevoja të veçanta. Kushti më i shpeshtë në këtë kategori janë orët shtesë ose orët shtesë për kompensim para orëve të rregullta. Në disa raste ofrohen trajtime pedagogjike dhe psiko- terapeutike. Në disa shkolla fillore në Mitrovica/Mitrovicë ofrohen terapi në të folur për fëmijët me aftësi të kufizuara të të mësuarit.

la vlen të theksohet se ka edhe programe të veçanta, si programet intensive ambulatorë (PIA-1 dhe PIA- 2) në shkolla të shumta në tërë Kosovën.

#### **f. Pjesëmarrja e prindërve dhe rrjetëzimi në komunitet**

Pjesëmarrja e prindërve vlerësohet të jetë përgjithësisht shumë pozitive. Pothuajse të gjitha shkollat organizojnë këshilla të prindërve, si pjesë të procesit arsimor. Prindërit janë shumë aktivë në organet e menaxhimit të shkollave. Ka edhe disa shembuj të këshillave të prindërve në nivel komunal, si në Štrpce/Shtërpçë. Gjithashtu janë të përhapura iniciativa të tjera, si takimet prindër – mësimdhënës/profesorë dhe tubime të përbashkëta për diskutimin e çështjeve, përzgjedhjen e librave, mungesat dhe për ekskursionë. Bashkëpunimi ndërmjet mësimdhënësve/profesorëve dhe prindërve forcohet edhe përmes "Ditëve me dyer të hapura" ("*Dani otvorenih vrata*"). Rast veçanërisht interesant është ai i Shkollës së Muzikës "Stevan Mokranjac" në Gračanica/Graçanicë, ku mësimdhënësit organizojnë mësimë publike për prindërit gjatë orëve mësimore të muzikës.

Është e qartë se shkollat janë akter i rëndësishëm social dhe kulturor për serbët dhe komunitetet e tjera në Kosovë. Shkollat shpesh organizojnë aktivitete kulturore dhe sociale që forcojnë frymën e komunitetit dhe aktivizmit qytetar në nivel lokal. Veçanërisht në mjedise në pjesën në jug të Ibrit, ku jeta socio-kulturore është tejet e vargër, shkollat janë akterë të pazëvendësueshëm.

#### **g. Bashkëpunimi dhe shkëmbimet**

Bashkëpunimi ndërmjet shkollave ka formën e garave, aktiviteteve të përbashkëta dhe ekskursionëve. Në përgjithësi, shkollat në gjuhën serbe janë shumë aktive në organizimin e punëtorive, seminareve, aktiviteteve kulturore dhe sportive me përfshirjen e shumë institucione në tërë Kosovën. Garat komunale dhe rajonale janë gjithashtu burim i rëndësishëm i shkëmbimit të përvojës dhe ndarjes së diturisë për nxënësit jo vetëm brenda Kosovës, por edhe me shkollat në Serbi. Shumë pak shkolla nuk janë pjesë e këtij mjedisi dinamik siç është rasti me shkollën fillore në Partes/Partesh ("*Dositej Obradoviq*"), e cila insiston që të ketë më shumë bashkëpunim. Sipas anketave, shkollat në komunën e Leposavić/Leposaviqit dhe atë të Zubin Potokut presin bashkëpunim më të mirë.

#### **h. Mbështetja e jashtme dhe/ose investimet**

Shkollat që ofrojnë arsimim në gjuhën serbe janë hapur ndaj investimeve të jashtme vetëm kohët e fundit. Duke shfrytëzuar mekanizmat e decentralizuar për mbrojtjen dhe promovimin e të gjitha



komuniteteve në Kosovë, shkollat në gjuhën serbe kanë aplikuar për mbështetje dhe donacione dhe kanë marrë të tilla nga organizatat ndërkombëtare dhe autoritetet komunale të Kosovës.

Rajonet që përfitojnë më së shumti nga investimet e jashtme janë Gnjilane/Gjilani dhe Priština/Prishtina. Sipas intervistave, nuk ka pasur fare investime në komunën Uroševac/Ferizaj, dhe shumë pak në atë të Peć/Pejë dhe Prizrenit.

### **Shkolla Fillore "Jovan Cvijiq" në Zubin Potok**

Kjo shkollë, ku ndjekin mësimin 542 nxënës, ka përfituar nga donacionet e organizatës ndërkombëtare Save the Children dhe USAID-it. Ndërtesa e kësaj shkolle është në kushte shumë të mira dhe posedon klasa të specializuara mësimi.

BE dhe USAID janë donatorët më të shpeshtë, të cilët kryesisht ofrojnë kompjuterë dhe rinovojnë ndërtesa. Në Klokot/Kllokot, shkolla e re "Sveti Sava" është ndërtuar me mbështetjen financiare të BE-së, dhe ka kushte vërtet të mira. Shembuj të tjerë të përkrahjes nga donatorët ndërkombëtarë që kontribuojnë në përmirësimin e kushteve për mësimdhënie përfshijnë nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZh) në komunën e Parteš/Parteshit, dhe nga Organizata Ndërkombëtare për Migrim (IOM), në komunën e Novo Brdo/Novobërdës dhe Ranilug/Ranillug.

Shumë OJQ lokale kanë qenë donatorë aktivë, si Solidariteti për Kosovën – Arno Gujon, në Kosovo Polje/Fushë-Kosovë dhe komunën e Priština/Prishtinës.

Krejt në fund, Qeveria e Republikës së Serbisë investon në arsimimin në gjuhën serbe në Kosovë, qoftë nëpërmjet 'Zyrës për Kosovë dhe Metohi' apo Ministrisë së Arsimit. Mbështetja kryesisht shkon në renovimin e ndërtesave. Për shembull, në shkollën "Vuk Karaxhiq" në Lipjan/Lipjan është ndërtuar terren i ri sportiv, janë rinovuar paralelet e ndara dhe është dhuruar një bibliotekë të re. Në të njëjtën mënyrë, Shkolla Bujqësore në komunën e Leposavić/Leposaviqit dhe shkolla fillore në Brnjak/Bërnjak gjithashtu kanë përfituar mbështetje nga institucionet e Serbisë.

### **Shkolla Fillore "Sveti Sava" në Sušica/Shushicë**

Sipas Departamentit për Planifikim Urban të Komunës së Gračanica/Gračanicës, në Shkollën Fillore "Sveti Sava" në Sušica/Shushicë janë rinovuar disa dhoma mësimi. Në të janë rinovuar dyshemeja, rrjeti, mozaiku dhe fasadat në tavanin e katër dhomave të mësimi, dhe gjithashtu janë rinovuar strehët e objektit dhe tualetet. Për këto investime janë dedikuar fonde që arrijnë shumën prej në 2,303 eurosh, të ndara nga buxheti i Komunës. Shkolla ka shprehur mirënjohjen për fondet e ndara dhe përpjekjet për të siguruar kushte më të mira të punës për fëmijët.

Shkollat në gjuhën serbe, ndonëse nuk njihen nga Ministria e Arsimit e Kosovës, përfitojnë nga mbështetja nga ana e komunave me shumicë serbe që veprojnë brenda sistemit kosovar. Në të vërtetë, shkollat në komunën e Mitrovica/Mitrovicës së Veriut kanë përfituar përkrahje financiare me mjete të ndara nga Ministria e Arsimit dhe të shpërndara nga Komuna, në shumë prej gjithsej rreth 1,564,600 eurosh brenda një periudhe prej tre vjetësh (2015/2016/2017).

Megjithatë, komuna e Mitrovica/Mitrovicë nuk është shembulli i vetëm i investimeve kosovare në shkollat në gjuhën serbe: në shkollën fillore "Vuk Karaxhiq" në Lepinë, MASHT ka financuar rinovimin e fasadave, vendosjen e izolimit termik dhe zëvendësimin e dritareve të kulmit. Për këtë ministria i ka ndarë Drejtorisë së Arsimit të Komunës së Gračanica/Gračanicë fonde në vlerë prej 12,502 eurosh.

## i. Sfidat

Kjo pjesë është pjesa e fundit e pyetësorit që ka pyetje të hapura, ku të intervistuarve u është mundësuar të adresojnë lirisht të gjitha sfidat e veçanta për të ardhmen. Çështjet e ngritura nga të intervistuarit mund të klasifikohen në katër kategori, pra çështje që lidhen me (1) infrastrukturën e specializuar dhe problemet strukturore, (2) mungesën e nxënësve, (3) mungesën e mjeteve financiare dhe pasojat e kësaj, (4) sigurinë dhe transportin, dhe (5) gjithëpërfshirja në arsim.

(1) Shumica e shkollave ankohen për mungesën e infrastrukturës së specializuar, në veçanti të dhomave të mësimit ose kabineteve të destinuar për mësim praktik: laboratorëve dhe kabineteve shkencorë, të edukatës fizike dhe të TI-së. Siç është konfirmuar më sipër, mungesa e infrastrukturës së specializuar rëndon cilësinë e arsimit veçanërisht në shkollat e specializuara teknike. Për shembull, Shkolla e Mjekësisë, me konvikt, në Mitrovica/Mitrovicë ka raportuar për mungesën e kabineteve të kimisë, furnizimin e hapësirës për farmacistët e ardhshëm si dhe të pajisjeve për dhënie të mësimit teknikëve të dhëmbëve, si sfidat kryesore për të ardhmen. Ngjashëm, Shkolla Teknike e Vuçitrn/Vushtrrisë ka nevojë për hapësirë për praktikë profesionale. Në rajonin e Gnjilane/Gjilanit dhe atë të Uroševac/Ferizajt ka mungesë të madhe të sallave të mbyllura për edukatë fizike; pothuajse të gjitha shkollat kanë deklaruar se kanë nevojë për palestra për aktivitete brenda ndërtesave gjatë dimrit.

Një problem serioz që kanë treguar pyetësorët ka të bëjë me probleme strukturore me objektet ku mbahet mësimi. Është e qartë se për ato shkolla që duhet të ndajnë të njëjtat objekte sfida më e madhe është blerja e një ndërtese të re, siç ka deklaruar Gjimnazi në Uroševac/Ferizaj, Shkolla Teknike në Srbica/Skënderaj dhe Shkolla Ekonomike në Mitrovica/Mitrovicë. Çështje të tjera që kanë të bëjnë me mangësitë infrastrukturore janë problemet me ngrohje qendrore, renovimet e fasadave, dhe ndërimi i tualeteve, dritareve dhe deryeve. Gjendje alarmante është vënë në pah në Shkollën speciale "Kosovski Bozhur", e cili ka deklaruar se ka nevojë për qasje me karroca në objekt nga ana e shfrytëzuesve. Është thënë se në disa raste ka madje edhe nevoja thelbësore si mungesa e ujit të pijshëm, siç është rasti me Shkollën Elektro- Teknike në Priština/Prishtinë dhe në Vuçitrn/Vushtri.

(2) Anketa ka treguar një shqetësim serioz në lidhje rënien e numrit të nxënësve. Shumë shkolla kanë nënvizuar si sfidë rënien e numrit të nxënësve të regjistruar dhe rritjen e atyre që ç'regjistrohen. Arsytet e këtij fenomeni mund të përfshijnë ndjenjën e pasigurisë, pamundësinë për të zgjedhur shkollimin e dëshiruar, ndërtesa shkollore të papërshtatshme dhe jo të pajisura i duhet, kushtet e vështira ekonomike, mungesën e mundësive për punësim me diplomat e marra, gjë që shkakton migrimin në zona më të mëdha në Kosovë ose jashtë vendit.

Ky fenomen nënkupton rënien e numrit të fëmijëve që ndjekin shkollat në fshatra të vogla, kryesisht në nivelin fillor. Prandaj, frika më e madhe e shprehur nga ana e drejtorëve të shkollave është mbyllja e përhershme e shkollave të tyre.

### Shkolla Bujqësore në Lešak/Leshak

Kjo shkollë paraqet një shembull të plotë të sfidave të raportuara nga të intervistuarit. Problemi më serioz me të cilin ballafaqohet kjo shkollë është mungesa e tokës ku nxënësit mund të ushtrojnë dhe të fitojnë njohuri të domosdoshme për specializimin e tyre. Përveç kësaj, drejtori i shkollës ka konfirmuar mungesën e burimeve themelore mësimore, si traktorëve, kamionëve dhe orendive. Edhe në këtë rast, shkurtimet financiare pengojnë arsimimin e specializuar në këtë shkollë. Edhe ndërtesa e kësaj shkolle ka dëmtime të rënda. Ka nevojë për renovimin e katit përdhese dhe të ngrohtores, si dhe për ndërtimin e murit rrethues. Oborri nuk është i rrethuar dhe mobilet duhet rinovuar.

(3) Arsyeja e këtyre mungesave është mungesa e burimeve financiare. Vështirësitë financiare që janë përmendur vazhdimisht kanë ndikim në materiale dhe pajisje, organizimin e seminareve edukative, aktivitetet jashtë orarit mësimor, renovimin e mobileve, dhe madje edhe në problemet me pagesën e faturave të energjisë. Mungesa e burimeve financiare gjithashtu nënkupton mungesën e pajisjeve të specializuara, si në rastin në Shkollën Bujqësore në Lešak/Leshak, e cili ka deklaruar se ka nevojë për makineri për të kryer në mënyrë të pandërprerë pjesën praktike të programit mësimor.

(4) Siguria dhe transporti përbëjnë shqetësime të veçanta për shkollat në gjuhën serbe në Kosovë. Në shumë raste nuk ofrohet fare transport për në shkollë dhe, edhe nëse është në dispozicion, transporti duket të jetë jo i rregullt dhe i organizuar nga kompanitë private. Kjo pengesë ka ndikim veçanërisht në rajonin e Peć/Pejës dhe atë të Priština/Prishtinës. Megjithatë, siguria e ofrimit të transportit ka të bëjë me një brengë më të gjerë të sigurisë së nxënësve në trafik, për shkak të ndërlidhjes me tensione etnike. Disa shkolla nuk kanë rrethoja adekuate, duke i vënë kështu nxënësit në rrezik nga automjetet dhe ndërtesat në rrezik të vjedhjes dhe plaçkitjes (siç ka deklaruar shkolla në Novo Brdo/Novobërdë dhe në Gnjilane/Gjilan). Në rastet kur shkollat në gjuhën serbe dhe ato në gjuhën shqipe gjenden në të njëjtën ndërtesë, janë ngritur shqetësime në lidhje me tensionet mes nxënësve. Për shkak të mungesës së hapësirës, ka raste kur sistemet arsimore në gjuhën serbe dhe ato në gjuhën shqipe duhet të ndajnë të njëjtat ndërtesa. Kështu është rasti me shkollën fillore "22 Dhjetori" në Restelicë dhe atë "Zenuni" në Brod, në rajonin e Gorës. Megjithatë, nuk ka kurrfarë forme ndërveprimi ose kontakti mes administratave të këtyre shkollave.

(5) Sfida e fundit e raportuar nga përfaqësuesit e shkollave në gjuhën serbe është gjithëpërfshirja në arsim, në veçanti në ndërlidhje me përfshirjen etnike, përfshirjen sociale dhe përfshirjen e nxënësve me aftësi të kufizuara të të mësuarit. Në Mitrovica/Mitrovicë, rasti i shkollës "Vladko Cetković", e cila ka një numër të madh nxënësish romë, tregon për sfidën e kryerjes së aktiviteteve të veçanta arsimore për përfshirjen e komunitetit rom. Në Zvečan/Zveçan, shkolla teknike ka theksuar problemin e përdorimit të drogës në mesin e nxënësve, gjë që i atribuohet problemeve të rënda socio-ekonomike. Përmirësimi i gjithëpërfshirjes në arsim teknikave të të mësuarit për nxënësit me vështirësi në të nxënit konsiderohet prioritet në shkollën fillore "Branko Radiçević".

## **4. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME**

Vlerësimi i gjendjes së shkollave në gjuhën serbe në Kosovë përbën një nga prioritetet më të rëndësishëm në kuadër të kornizës për mbrojtjen e komuniteteve në vend. Marrë parasysh specifikat e sistemit arsimor kosovar, është jetike që të vlerësohet cilësia e arsimit që ofrohet në 104 shkolla në gjuhën serbe, kjo në mënyrë që të mund të kihet një vlerësim gjithëpërfshirës i cilësisë së arsimit në Kosovë. Aktivitetet në të ardhmen për përmirësimin e arsimit në Kosovë duhet të përfshijnë të gjitha sistemet në vend. Qëllimi i këtij raporti është të ofrojë një analizë cilësore të shkollave në gjuhën serbe për të trajtuar çfarëdo problemesh serioze ose mungesën e kapaciteteve në arsim. Rekomandimet në vijim duhet t'u hapin rrugën masave efektive për të ndihmuar dhe mbështetur të gjitha shkollat që kanë nevojë për mbështetje ekonomike ose rinovime urgjente të infrastrukturës së tyre.

Përveç kësaj, duhet të theksohet diçka e rëndësishme. Tabloja që paraqesin intervistat tregon është shumë e larmishme, sidomos nëse krahasojmë katër komunat në veri të Kosovës dhe zonat e populluara me pjesëtarë të komunitetit serb të shpërndara në pjesën tjetër të Kosovës. Mund të vihet re se shkollat në katër komunat veriore kanë kushte më të mira pune dhe pajisje sesa shkollat në gjuhën serbe në pjesën tjetër të Kosovës.

### **a. Të sigurohet transport i sigurtë dhe i besueshëm publik për shkollat**

Shumica e shkollave janë të përqendruara në rajonin e Mitrovica/Mitrovicës dhe atë të Priština/Prishtinës, ku nxënësit nuk duhet të udhëtojnë gjata për të ndjekur mësimin. Në rajone të tjera, si Gnjilane/Gjilani dhe Prizreni, cilësia e transportit është shumë e dobët. Për pasojë, rreziku i braktisjes në këto raste është shumë e lartë, për shkak të vështirësive për të ndjekur mësimin rregullisht. Për të rritur gjithëpërfshirjen në arsim, autoritetet qendrore duhet të ndër marrin veprime për të krijuar mundësi të barabarta për qasjen e të gjithë fëmijëve në shkolla. Për të adresuar largësinë e madhe të shkollave, sistemi i arsimit në gjuhën serbe është gjerësisht i organizuar në rrjete të paraleleve të ndara, sidomos në klasat 1 – 4 të shkollës fillore. Megjithatë, ndërtesat e mbuluara në këtë studim, në shumicën e rasteve, fillimisht nuk ishin menduar për qëllime arsimore, dhe kjo dëmton cilësinë e arsimit. Në raste të tilla, transporti i besueshëm dhe i sigurt publik për shkolla moderne dhe të pajisura mirë mund të sigurojë një zgjidhje më të qëndrueshme.

### **b. Mungesa e nxënësve në shkollat rurale**

Kur jemi te sfidat, rënia e numrit të nxënësve në shumë shkolla në gjuhën serbe paraqet një problem të vazhdueshëm. Për të trajtuar çështjen e mbylljes së shkollave në zonat rurale, për shkak të numrit të vogël të nxënësve të regjistruar, duhet të rritet përfshirja e komunitetit në marrjen e vendimeve. Çfarëdo propozimesh të dala nga konsultimet lokale dhe me komunitetet, të cilët mund të përgatisin terrenin për zgjidhje, duhet të merren parasysh për të ardhmen e këtyre komuniteteve dhe për mirëqenien e fëmijëve. Këto procese duhet të sigurojnë që fëmijët të ndjekin shkollimin në zonat rurale të kenë të njëjtat mundësi si ata në zonat urbane.

### **c. Të harmonizohet numri i nxënësve për një mësimdhënës/profesor**

Proporcioni nxënës-mësimdhënës/profesor në shkollat në gjuhën serbe në Kosovë nuk është në përputhje me mesataren evropiane të proporcionit nxënës-mësimdhënës/profesor. Siç u diskutua

më sipër, proporcioni është veçanërisht e pafavorshëm në paralelet e ndara në rajonet jugore të Kosovës. Shkollat vuajnë nga mungesa e nxënësve, gjë që shpjegon numrin e vogël të nxënësve për një mësimdhënës. Nga këndvështrimi ekonomik, kjo gjendje tregon mungesë efikasiteti dhe duhet të trajtohet. Nga ana tjetër, në rajonin e Mitrovica/Mitrovicës dhe atë të Priština/Prishtinës shkollat përballen me problemin e kundërt, pra me mungesën e hapësirave dhe të infrastrukturës, sidomos në komunat me shumicë serbe. Për të shmangur këtë problem, shkollat që mbajnë mësim në të njëjtat ndërtesat me institucione të tjera arsimore mbajnë mësim në ndërrime të paradites dhe pasdites. Pasojat e këtyre kushteve të të mësuarit në cilësinë dhe rezultatet e nxënësve nuk duhet nënvlerësuar.

#### **d. Të investohet në infrastrukturën e shkollave**

Sa i përket infrastrukturës, vlerësimi vë në dukje disa shqetësime serioze. Në pjesën jugore të vendit shkollat funksionojnë në ndërtesa që nuk janë të destinuara për këtë qëllim, dhe që si të tilla janë joadekuate për zhvillimin e procesit mësimor. Brengat më të mëdha në këto shkolla janë kushtet higjienike dhe mungesa e tualeteve brenda ndërtesave, sidomos në shkollat në rajonin e Gorës. Ekzistimi i tualeteve të improvizuara, që nuk janë adekuate, që është vënë në dukje në shumë shkolla, duhet të trajtohet menjëherë. Përveç kësaj, gjetjet tregojnë mungesën e laboratorëve dhe pajisjeve për mësim praktik në kabinete, si në shkollat fillore ashtu edhe ato të mesme. Kjo bën që të ketë rezultate të dobëta mësimore në shkollat e specializuara shkencore (në shkolla të mjekësisë, bujqësore, teknike, ekonomike...). Mungesa e pajisjeve të TI- së gjithashtu përbën pengesë për arsimim në përputhje me standardet evropiane. Për të arritur nivelin evropian, preferohet shumë që të ndihmuar këto shkolla duke iu ofruar mobile të përshtatshme (numër të mjaftueshëm të karrigeve, tavolinave, dhe tabelave) dhe pajisje të nevojshme për laboratorë dhe kabinete. Dy shkolla kanë deklaruar se përballen me mungesën e ujit të pijshëm: mungesa e një kushti të tillë bazik përbën shkelje të hapur e fundamentale të të drejtave të fëmijëve për arsimim në këtë shekull.

Në shumë raste, donatorët ndërkombëtarë kanë siguruar pajisje teknike, sidomos në shkollat në rajonet veriore, por kjo nuk duhet të përgjithësohet. Kështu, donatorët ndërkombëtarë duhet të kenë në vëmendje të gjitha institucionet arsimore në vend, veçanërisht në rajonet jugore ku lidhjet me Republikën e Serbisë janë më të dobëta, për shkak të largësisë fizike. Gjendja është e ngjashme sa i përket sigurimit të materialeve mësimore. Përveç mjeteve themelore si tabelave për mësimdhënie dhe hartave gjeografike, ankesa më e shpeshtë ka të bëjë me tekstet shkollore dhe materialet mësimore. Disa drejtorë shkollash në pjesën jugore të Kosovës kanë kërkuar me forcë më shumë vëmendje për nevojën e tyre për tekste zyrtare në gjuhën serbe, gjë që është thelbësore për banorët për zhvillimin e arsimit të standardizuar.

#### **e. Rekomandim lidhur me koordinimin dhe mbështetjen**

Iniciativat për të ndihmuar shkollat në gjuhën serbe në Kosovë deri më tani kanë qenë të fragmentuara dhe pa objektiva të qarta. Komunat veriore përfitojnë nga afërsia me Serbinë dhe mundësi të shumta për punëtori të përbashkëta, seminare dhe iniciativa të tjera. Pas shumë vitesh izolimi, shkollat në gjuhën serbe kohët e fundit janë hapur ndaj investimeve të jashtme. Donatorët ndërkombëtarë, veçanërisht BE dhe USAID-i, kanë qenë më bujarë. Republika e Serbisë dhe 'Zyra për Kosovën dhe Metohinë' atje kryesisht janë fokusuar në mbështetjen e shkollave që gjenden në rajonet veriore. Sfidat e identifikuar gjatë intervistave kanë të bëjnë kryesisht me nevoja infrastrukturore dhe gjendjen joadekuate të objekteve ku mbahet mësimi, mungesën e fondeve dhe problemet me transport.

Megjithatë, nevojitet veprim i koordinuar për të mbështetur shkollat në gjuhën serbe. Duhet të hartohet një plan i përbashkët për mbështetje afatgjatë dhe për të krijuar zgjidhje të qëndrueshme. Koordinimi i duhur financiar mes autoriteteve kosovare, qeverisë së Serbisë dhe komunitetit ndërkombëtar do të shmangte humbjen e energjive dhe fondeve, por edhe të kohës, e cila, në këtë kohë të përparimit të shkencës dhe teknologjisë, është e vlefshme kur bëhet fjalë për edukimin popullsisë më të re.

Një plani të asistencës duhet t'i paraprihet një analizë e thellë e gjendjes së shkollave në gjuhën serbe në Kosovë. Mungesa e transparencës dhe njohurive është arsyeja kryesore e mbështetjes së pakoordinuar dhe neglizhencës ndaj këtyre institucioneve arsimore. Si kontribut drejt këtij qëllimi, ky raport përbën një përpjekje të parë për të identifikuar gjendjen e shkollave në gjuhën serbe në Kosovë dhe për të siguruar të dhëna themelore që do të lehtësonin ofrimin e ndihmës dhe mbështetjes.

## REFERENCAT

Korniza ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Kuvendi i Republikës së Kosovës, 2008.

<http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Kushtetuta.e.Republikes.se.Kosoves.pdf>

*Ligji nr. 02/L-37 për Përdorimin e Gjuhëve.* Kuvendi i Republikës së Kosovës, 2006.

[http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2006\\_02-L37\\_al.pdf](http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2006_02-L37_al.pdf)

*Ligji nr. 03/L-047 për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Kosovë.* Kuvendi i Republikës së Kosovës, 2008.

[http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2008\\_03-L047\\_al.pdf](http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2008_03-L047_al.pdf)

*Ligji nr. 03/L-068 për Arsim në Komunat e Republikës së Kosovës. Kuvendi i Republikës së Kosovës, 2008.*

<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2543>

*Ligji nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës. Kuvendi i Republikës së Kosovës, 2011.*

<http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Ligji%20per%20arsimin%20parauniversitar.pdf>

ЗАКОН о основама система образовања и васпитања, 2017.

<https://www.pedagog.rs/wp-content/uploads/2017/10/zosov2017.pdf?v=e892e780304d>

### **Marrëveshjet ndërkombëtare**

*Konventa Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare.* Këshilli i Evropës, 1995.

<https://rm.coe.int/16800c10cf>

*Karta Evropiane për Gjuhët Rajonale dhe të Pakicave.* Këshilli i Evropës, 1992.

<https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list/-/conventions/rms/0900001680695175>

*Treguesit Evropa 2020 – Arsimi.* Këshilli Evropian, 2017.

[http://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php/Europe\\_2020\\_indicators\\_-\\_education](http://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php/Europe_2020_indicators_-_education)

*Raporti Evropian mbi Cilësinë e Arsimimit në Shkollë, Gjashtëmbëdhjetë Tregues të Cilësisë.* Drejtorja e Përgjithshme për Arsim dhe Kulturë – Komisioni Evropian, 2000.

<http://aei.pitt.edu/42406/1/A6503.pdf>



**SHKOLLAT FILLORE**

RAJONI	KOMUNA	EMRI I INSTITUCIONIT	NUMRI I NXËNËSV E	NUMRI I MËSIMDHËNËSVE	NUMRI I STAFIT
FERIZAJ/ UROŠEVAC	Štrpce/ Shtërpçë	Sharski Odred	348	61	6
		Stojan Marković	505	60	33
		Rajko Urošević	150	15	10
PËJË/ PEĆ	Goraždevac/ Gorazhdec	Janko Jovičević	84	21	13
		Radosh Toshić	40	25	2
	Istog/Istok	Jedinstvo	6	3	1
GJILAN/ GNJILANE	Parteš/ Partesh	Dositej Obradović	198	35	3
		Milladin Popović	230	29	2
	Gjilan/Gnjilane	Bora Stanković	118	48	14
		Shkolla e Muzikës Stevan Hristić	465 <sup>16</sup>	70	15
		Vuk Karadžić	275	50	8
		Petar Petrović Njegosh	182	33	5
		Branko Radičević	10	10	5
	Klokot/Kllokot	Sveti Sava	102	19	6
	Viti/Vitina	Marko Rajović	164	34	15
		Mladen Marković	23	30	12
	Ranilug/ Ranilug	Trajko Perić	197	60	3
		Veljko Dugoshević	256	48	5
	Kamenicë/ Kamenica	Desanka Maksimović	289	74	3
		9 Maji	15	15	11
		Bratstvo	39	15	10
PRISHTINË/ PRIŠTINA	Gračanica/ Gračanice	Kralj Millutin	684	65	6
		Knez L Lazar	493	63	8
		Milladin Mitić	456	46	7
		Shkolla e Muzikës Stevan Mokranjac	130	13	6
	Fushë Kosovë/ Kosovo Polje	Uglarë	132	21	4
		Aca Marović	91	26	4
	Lipjan/Lipljan	Vëllezërit Aksiq	140	56	6
		Vuk Karaxhiq	124	30	4
		Vlladimir Nazor	70	15	10
	Obiliq/Obilić	Dositej Obradović	50	22	3
		Millan Rakić	104	17	17
		Branko Radičević	22	10	8
		Sveti Sava	/	/	/17

<sup>16</sup>. Numri i përgjithshëm i nxënësve të institucioneve fillore dhe të mesme

<sup>17</sup>. Ky institucion nuk ka dhënë informata.



	Prishtina/ Priština	Dimitrije Prica	21	18	3
		Sveti Sava	/	/	/ <sup>18</sup>
	Novo Brdo/ Novobërdë	Milladin Popoviq	59	22	4
		Sveti Sava	32	21	4
		Dositej Obradoviq	87	25	3
		Sveti Sava	13	13	10
<b>PRIZREN</b>	Dragash/ Dragaš	Nebojsa Jerkoviq	134	15	4
		22 Dhjetori	259	27	4
		9 Maji	82	14	7
		25 Maji	36	14	2
		5 Tetori	70	15	2
		Zenuni	65	17	2
	Rahovec/ Orahovac	Dositej Obradoviq	43	20	4
		Svetollar Markoviq	53	20	6
<b>MITROVICA/ MITROVICË</b>	Mitrovica/ Mitrovicë	Vllatko Ćetkoviq	185	8	4
		Dositej Obradoviq	85	20	4
		Miodrag Vasiljeviq	35	27	8
		Kosovski Bozhur	34	22	2
		Sveti Sava	817	63	3
		Branko Radiçeviq	601	46	3
		Predrag dhe Miodrag Mihajlloviq	/ <sup>19</sup>	/	/
		Desanka Maksimoviq	/ <sup>20</sup>	/	/
	Leposavić/ Leposaviq	Leposavić/Leposaviq	700	70	24
		Vuk Karaxhiq	270	37	5
		Stana Baçanin	358	64	3
	Skënderaj/ Srbica	MiLlun Jakshiq <sup>21</sup>	/	/	/
	Vushtrri/ Vuçitrn	Sveti Sava	50	18	12
		Vuk Karaxhiq	280	40	11
		21 Nëntori	7	12	4
	Zubin Potok	Petar Koçiq	60	30	5
		Blagoje Radiq	75	22	4
		Jovan Cvijiq	542	56	3
	Zvečan/ Zveçan	Sveti Sava	124	22	14
		Vuk Karaxhiq	533	16	3
		Strahinja Banoviq Banjska	39	17	4

<sup>18</sup>. Ky institucion nuk ka dhënë informata.

<sup>19</sup>. Ky institucion nuk ka dhënë informata.

<sup>20</sup>. Ky institucion nuk ka dhënë informata.

<sup>21</sup>. Ky institucion nuk ka dhënë informata..

**SHKOLLAT E MESME**

RAJONI	KOMUNA	EMRI I INSTITUCIONIT	NUMRI I NXËNËSV E	NUMRI I MËSIMDHËNËSVE	NUMRI I STAFIT
FERIZAJ/ UROŠEVAC	Štrpce/ Shtërpçë	Jovan Cvijiq	452	88	12
PËJË/ PEĆ	Goraždevac/ Gorazhdec	Shkolla Ekonomike	22	20	10
		Gjimnazi	18	20	7
GJILAN/ GNJILANE	Gjilan/ Gnjilane	Gjimnazi	142	52	6
		Shkolla e Muzikës Stevan Hristiq	465 <sup>22</sup>	70	15
		Shkolla Teknike - Dragi Popoviq	120	45	6
	Ranilug/ Ranillug	Shkolla Ekonomike dhe e Tregtisë	36	24	5
	Kamenicë/ Kamenica	Gjimnazi	100	45	5
		Shkolla Teknike	82	36	5
		Medical School	168	24	10
PRISHTINË/ PRIŠTINA	Gračanica/ Graçanicë	Shkolla Elektro- Teknike Milladin Popoviq	142	41	6
		Shkolla e Mjekësisë	323	72	8
		Shkolla e Muzikës Stevan Mokranjac	27	13	6
		Gjimnazi	114	26	5
		Shkolla Ekonomike dhe e Tregtisë	240	52	13
		Shkolla e Ndërtimtarisë dhe e Komunikacionit	107	36	4
	Prishtinë/ Pristina	Shkolla e Inxhinierisë Mekanike	31	20	5
Lipjan/ Lipljan	Shkolla e Bujqësisë	/	/	/ <sup>23</sup>	
	Lipjan/ Lipljan	Gjimnazi	/	/	/ <sup>24</sup>
PRIZREN	Dragash/ Dragaš	Shkolla Ekonomike dhe e Turizmit	150	23	2
	Rahovec/ Orahovac	Gjimnazi	9	16	4

<sup>22</sup>. Numri i përgjithshëm i nxënësve të institucioneve fillore dhe të mesme.

<sup>23</sup>. Ky institucion nuk ka dhënë informata.

<sup>24</sup>. Ky institucion nuk ka dhënë informata.

<b>MITROVICA/ MITROVICË</b>	Mitrovica/ Mitrovicë	Dega shoqërore- gjuhësore dhe ajo natyrore- matematikore	326	35	5
		GjimnazidheShkolla Teknikenë Vuçitrn/ Vushtrri	73	33	4
		Shkolla Ekonomike dhe e Tregtisë	202	44	2
		Miodrag Vasiljeviq	280	27	8
		Shkolla për nxënës me nevoja të veçanta 'Kosovski Bozhur'	12	22	2
		Shkolla e Mjekësisëme konvikt nëMitrovica/Mitrovicë	527	78	3
		Shkolla Teknike Mihajllo Petroviq Allas	278	Nuk ka informata <sup>25</sup>	Nuk ka informata <sup>26</sup>
	Leposaviç/ Leposaviq	Nikolla Tesla	380	50	3
		Shkolla e Bujqësisë – Leshak	150	40	10
	Skënderaj/ Srbica	Shkolla Teknike	21	8	2
	Vushtrri/ Vuçitrn	Shkolla Teknike Nikolla Tesla	74	32	10
	Zubin Potok	Grigorije Bozhoviq	239	52	3
	Zvečan/ Zveçan	Shkolla e Mesme	205	42	3

<sup>25</sup>. Ky institucion nuk ka dhënë informata.

<sup>26</sup>. Ky institucion nuk ka dhënë informata.





## ECMI Kosovo Contact Details

Rr. Zahir Pajaziti Nr.20 Apt.5  
10000 Prishtinë/Priština, Kosovo  
Tel. +381 (0) 38 224 473

Rr. Kralja Petra I 183a,  
38220 Mitrovica/Mitrovicë North, Kosovo  
Tel. +381 (0) 433 10 40

✉ [info@ecmikosovo.org](mailto:info@ecmikosovo.org)

🌐 [www.ecmikosovo.org](http://www.ecmikosovo.org)

Find Us Online!



 **European  
Union**  
Kosovo

  
**NORWEGIAN EMBASSY**  
Co-financed by the  
Royal Norwegian Embassy in Pristina

Implemented by:



**EUROPEAN CENTRE  
FOR MINORITY  
ISSUES KOSOVO**